

VENDIM
Nr. 614, datë 31.8.2016

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN “KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR
SHQIPËRISË” (PËR ANKIMIN NR. 32382/11)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimin nr. 32382/11, në shumën 5 919 850 (pesë milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, sipas listës së kërkuessve në shtojcën 1, që bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit, të konvertohen në lekë në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuessve, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimit në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve në çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimin nr. 32382/11, bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit, brenda 3 muajve nga data kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Titulli i çështjes dhe nr.	Emri i aplikantëve (viti i lindjes)	Vendqëndrimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes së kërkesës
<i>Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë</i> <i>Aplikimi nr. 32382/11</i>	Eni Kokona (1976) Lindita Kokona (1948) Xhejni Kokona (1978) Nirvana Rradhesi (1951) Shpresa Halimi (1969) Dhurata Bungo Karagjozi (1937) Dëshira Efovia Karagjozi (1936) Suzana Gjebrea Çami (1958) Hiqmet Çami (1924) Hasibe Kulla Çami (1966) Besnik Çami (1961) Agim Karagjozi (1927) Albert Karagjozi (1934) Vesim Karagjozi (1931) Bukuroshe Dobi Karagjozi (1929) Armand Viçani (1958) Miranda Viçani Telegrafi (1949) Diana Kaltani Halimi (1936) Ermal Halimi (1959) Karolina Halimi (1935) Ariel Halimi (1963)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri SHBA Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Kanada Kanada SHBA Shqipëri SHBA SHBA SHBA SHBA SHBA SHBA Kanada Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Puto, avokat	14 mars 2011